Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2027.

2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 10/001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumë prej 300,000€ (treqind mijë eurosh) për organizimin e pjesëmarrjes së Kosovës në Forumin Ekonomik Botëror - Davos, me "Kosova House".

2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami "Programi për Promovim të Vendit" dhe barten në xhirollogarinë e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP).

3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 8, të Ligjit Nr. 10/001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjetet financiare në shumë prej 24,000€ (njëzetekatër mijë eurosh) për Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare për organizimin e Forumit të Tretë (3) Gjermano-Kosovar, i cili është mbajtur nga 28 deri më 30 tetor 2026.

2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi ndahen nga buxheti i Zyrës së Kryeministrit, nënprogrami "Programi për Promovim të Vendit" dhe barten në xhirollogarinë e përcaktuar nga Oda Ekonomike Gjermano-Kosovare.

3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 10/L-001, Ligjit Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Nëntëmujor Financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës, për vitin 2026.

2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij Vendimi ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në pajtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.

2. Obligohen Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 10, paragrafi 12, të Ligjit Nr.10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 200,000€ (dyqind mijë eurosh), për zbatimin e Marrëveshjes me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

2. Mjetet buxhetore sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, kodi 201, nga nënprogrami "Marrëveshjet me trupat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara", kodi 34100, nga kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", dhe transferohen në Ministrinë e Drejtësisë, me kod 215, në nënprogramin "Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave", me kod 27000, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".

3. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.